

DISLEKSIA – VËSHTIRËSITË E TË NXËNIT

Ç'është disleksia?

Disleksia është një term që tregon një paaftësi të veçantë të procesit të leximit. Nga ana mjekësore, përkufizohet si një gjendje që rezulton nga shkaqe gjenetike, neurologjike ose të pjekurisë. Disleksia është një çrregullim i manifestuar nga vështirësitë që hasen, kur fëmijët mësojnë të lexojnë dhe lidhet me vështirësinë që ka individit për të lexuar, apo për të perceptuar shkronjat. Kryesisht, kjo vështirësi shfaqet për ato shkronja që kanë nga ana pamore karakteristika të përafërta, siç mund të jenë shkronjat e vogla “p” me “q”, ose “b” me “d”, pavarësisht mësimit konvencional, inteligjencës personale të individit apo mundësive social-kulturore.

Disleksia është rezultat i dështimit/i paaftësisë së njëres nga dy hemisferat e trurit për të dominuar zhvillimin e gjuhës. Fillimisht, studiuesit kërkonin një shkak të vetëm të disleksisë, por tani të gjithë besojnë se ka shumë faktorë që ndikojnë në të. Disa mendojnë se shkaktohet nga defektet vizuale dhe motorike, si p.sh. ndjekja me sy ose lëvizja e syve. Të dy problemet, si ai pamor, edhe mungesa e dominancës (ekuilibrit) cerebrale konsiderohen si shkaqe të mundshme të disleksisë. Disa studiues të tjerë mendojnë se ajo shkaktohet nga ndryshimet në pjesë të veçanta të trurit. Të dhënat tregojnë se njerëzit me disleksi kanë një prapambetje në maturimin e trurit dhe një shkallë të lartë të përdorimit të dorës së majtë, pra shfaqet më shumë te mëngjarashët. Këto dukuri mund të tregojnë ndryshime në funksionimin e trurit.

Disa studiues të tjerë teorizojnë se çrregullimet në strukturën e trurit mund të jenë një faktor tjetër. Kjo teori fillimisht nuk është pranuar, por në ekzaminimet e trurit mbas vdekjes së personave me disleksi, janë vënë re çrregullime karakteristike të trurit. Megjithatë, debati për këtë teori vazhdon, pasi ka studiues që mendojnë se mund të jetë deri diku e vlefshme.

Disa ekspertë thonë se disleksia mund t'i atribuohet edhe metodave të mësimdhënies. P.sh. ata kritikojnë metodën e mësimit të leximit, nëpërmjet

metodës së përgjithshme të mësimit të gjuhës dhe mendojnë se nxënësit me disleksi mund të mësojnë të lexojnë më lehtë, duke përdorur metodën fonetike. Ndërsa specialistë të tjerë mendojnë se leximi mund t'u mësohet këtyre nxënësve, duke përdorur një kombinim të të dyja metodave, si atë fonetike, edhe atë të mësimit të gjuhës.

Teknologjia e avancuar e imazheve ka bërë të mundur identifikimin e modeleve të veçanta të aktivitetit të trurit. Shkencëtarët tashmë janë në gjendje të identifikojnë keqfunksionimet e trurit që përfshihen në disleksi. Duke përdorur imazhet e rezonancës magnetike, mund të vëzhgohen imazhe të trurit në kompjuter, ndërkohë që individit kryen detyra të ndryshme dhe lexon pasazhe të ndryshme. Këto imazhe treguan se personi me disleksi ka më pak aktivitet të trurit në ato zona që lidhin fjalën e shkruar me komponentët fonikë. Ky mosfunksionim i trurit në kohë e bën të vështirë përpunimin e saktë të tingujve të të folurit. Mungesa e vetëdijes fonemike është ajo çka e dallon nxënësin me disleksi nga nxënësit pa disleksi.

Disa studiues kanë zbuluar se njerëzit me disleksi nuk kanë më shumë probleme me sytë sesa njerëzit pa disleksi. Mprehtësia e tyre vizuale, përshtatja okulare, si dhe statusi i bashkimit (aliazhit) të lëvizjes spontane, nuk ndryshojnë nga ato të pjesës tjetër të popullsisë në përgjithësi. Megjithatë, një fëmijë me disleksi, çrregullimet e të cilit nuk janë diagnostikuar, do të ketë shumë vështirësi të mësojë të lexojë.

Ky çrregullim shfaqet në të gjitha grupmoshat, pavarësisht racës, gjinisë apo të ardhurave. Shfaqet te njerëzit me prejardhje të ndryshme dhe me nivele të ndryshme intelekti. Një nga faktorët më të rëndësishëm është edhe trashëgimia e familjes. Nëse një fëmijë ka një prind me disleksi, mundësia e trashëgimit dhe e transmetimit të këtij mosfunksionimi te fëmija mund të jetë 65%. Më parë, mendohej që prekte më shumë djemtë. Megjithatë, studimet më të fundit tregojnë që numri i vajzave me disleksi është i barabartë me atë të djemve. Shumë prej tyre janë të talentuar dhe me dhunti të veçanta në ato fusha ku nuk kërkohen shumë aftësi gjuhësore, si p.sh. në art, muzikë dhe sporte.

Diagnostikimi është shumë i rëndësishëm për të dalluar personin me vështirësi specifike të disleksisë. Zakonisht, mjeku është personi i parë që diagnostikon dhe verifikon problemin. Nëse është e nevojshme, duhet të bëhet një ekzaminim neurologjik dhe të përdoren disa instrumente vlerësimi për të gjetur se si problemet specifike të leximit janë të lidhura me aftësitë individuale, intelektuale, të perceptimit, aftësitë motorike, gjuhësore dhe të përshtatjes së personit në fjalë. Vetëm pas përcaktimit

të një diagnoze të saktë, mund të aplikohen teknika të përshtatshme të ndërhyrjes. Personat me disleksi kanë të njëjtën shkallë inteligjence si personat e tjerë të zakonshëm. Megjithëse një person i tillë mund të ketë prapambetje në lexim dhe në shprehitë/shkathësitë gjuhësore, leximit dhe shkrimit, mund të arrihet të paktën në një nivel funksional vetëm nëpërmjet programimit dhe mësimdhënies së individualizuar.

Në këtë vit shkollor ka pasur nxënës me disleksi, ashtu si edhe në vitet paraardhëse. Nuk kisha një informacion të saktë dhe ndihesa keq, kur një fëmijë në klasë të gjashtë nuk arrinte të lexonte (nxënësi A. L.), apo edhe kur dy nxënës të tjerë shkruanin me gabime (nxënësi A. F. dhenxënësja E. H.). Nuk kisha informacion të saktë rreth disleksisë dhe kjo gjë më shtyu të njihja më thellë këtë çrregullim dhe nxënësit me këtë simptomë.

Karakteristikat e nxënësit me disleksi

Nxënësit me disleksi mund të shfaqin njëriën ose më shumë nga karakteristikat e mëposhtme:

- Paaftësi për të mësuar dhe për të mbajtur mend fjalët vetëm duke i shikuar.
- Vështirësi në dekodim.
- Vështirësi në drejtshkrim.
- Mungesë/paafteisi në organizimin e materialeve.
- Vështirësi në gjetjen e fjalës së duhur, kur duan të komunikojnë me shkrim dhe me gojë.
- Nuk ka kënaqësi, kur lexon në mënyrë të pavarur.
- Vështirësi kur shkruan në diktim.
- Ndryshim/kthim të shkronjave dhe fjalëve (shkruan “b” ose “d”, ose me kokë poshtë).
- Vështirësi në grumbullimin dhe në gjetjen e fjalëve të shkruara.
- Memorie të dobët pamore për simbolet e gjuhës.
- Lëvizje/mospërqendrim të lëvizjeve të syve, kur lexojnë.
- Vështirësi në procesin e dëgjimit.
- Vështirësi për të zbatuar atë çfarë kanë lexuar në situata të ndryshme mësimore ose sociale.
- Shkrim dore i paqartë/i palexueshëm.
- Ngatërrojnë zanoret, ose zëvendësojnë një bashkëtingëllore me një tjetër.
- Aftësi motorike joadekuate të muskujve të vegjël.

Disleksia prek rreth 80% të atyre që etiketohen si “persona me paaftësi në procesin e të mësuarit”, ku shumica e karakteristikave janë të ngjashme. Të njëjtat strategji që përdorim për të mësuar nxënësit me aftësi të kufizuara (çrregullime në procesin e të mësuarit), janë të aplikueshme edhe për nxënësit me disleksi, të cilët gjithashtu kanë paaftësi në procesin e të mësuarit.

Shenjat e zakonshme të disleksisë te fëmijët parashkollorë

Në vitin 2008-2009, kur isha punonjëse e një kopshti, u përballa me rastin e dy fëmijëve. Njëri nuk mësonte dot ditët e javës, kurse tjetri nuk kopjonte dot shkronjat e mëdha të shtypit. Nuk kisha informacion të thelluar rreth disleksisë. Më poshtë, po përmend disa nga shenjat që shfaqin fëmijët disleksikë:

- Flasin më vonë se shumica e fëmijëve.
- Kanë vështirësi për t'i shqiptuar fjalët.
- Mësojnë më me ngadalë fjalë të reja.
- Mund të mos jenë në gjendje të gjejnë një fjalë të caktuar.
- Mund të kenë vështirësi për vjershat me rimë.
- Mund të kenë vështirësi në mësimin e alfabetit, të numrave, të ditëve të javës, të ngjyrave dhe formave.
- Mund të kenë vështirësi në shkrimin e emrit të tyre.
- Mund të kenë vështirësi në ndërveprimin me bashkëmoshatarët.
- Mund të mos jenë në gjendje të zbatojnë aktivitete që kanë disa kërkesa.
- Aftësitë e tyre motorike mund të zhvillohen më vonë se ato të fëmijëve të tjerë.
- Mund të kenë vështirësi në tregimin ose ritregimin e një historie, sipas një rendi të caktuar kronologjik.
- Shpesh kanë vështirësi në bashkimin e tingujve për të formuar fjalë, ose në gjetjen e tingujve që përbëjnë fjalën.¹

Më poshtë, po listoj disa nga vështirësitë në moshën kur fëmija lexon:

- Vështirësi në dekodimin e fjalëve të vetme (në leximin e fjalëve një për një).

- Mund të mësojë ngadalë lidhjen mes shkronjave dhe tingujve.
- Mund t'i ngatërrojë fjalët e shkurtra *në / me; për / por*.
- Bën vazhdimisht gabime në të lexuar, që lidhen me:
- përmbysjen e shkronjave - *lexon d në vend të b-së (berë për derë)*
- përmbysjen e fjalëve - *(pit për tip)*
- kthimin me kokë poshtë të shkronjave - *u për n*.
- Mund t'i ngatërrojë shenjat aritmetike (+ - x /=0).
- Mund të ketë vështirësi për të mbajtur mend faktet.
- Mund të mësojë me ngadalë aftësi të reja dhe kryesisht mëson përmendësh, pa kuptuar.
- Mund të jetë impulsiv dhe i gatshëm për t'u zënë me dikë.
- Shpesh e mban lapsin në mënyrë të çuditshme (për shembull e mban me grusht, ose me gishtin e madh).
- Mund të mos tregojë dot, se sa është ora.
- Mund të ketë koordinim të pamjaftueshëm motorik etj.²

Rëndësia e evidentimit të disleksikëve

Shpesh, ndodh që nxënësit disleksikë të etiketohen si dembelë, të rrëmujshëm dhe të pavëmendshëm. Ky lloj kategorizimi i pasaktë lë pasoja në zhvillimin e mëtejshëm emocional të fëmijëve, por jo vetëm. Disleksia ka kosto të larta emocionale dhe shoqërore për personat e prekur, si në fëmijëri, ashtu dhe në moshë të rritur (abuzim dhe dhunim, braktisje e edukimit, vetëvlërim i ulët), por edhe për komunitetin (duke pasur parasysh lidhjen e fortë midis braktisjes së shkollës dhe kriminalitetit, papunësisë, mosshfaqjen e talenteve etj.). Si faktorët socialë dhe mjedisorë (sistemi gjuhësor, cilësia e mësimdhënies, mjedisi familjar), ashtu edhe ata biologjikë (gjenet, aktiviteti i trurit), ndërveprojnë në zhvillimin dhe shfaqjen e problemeve me leximin. Faktorët mjedisorë (p.sh. ndërhyrja intensive apo mungesa e saj) zbusin apo ashpërsojnë shfaqjen e predispozitës gjenetike. Për këtë arsye, psikologët shkollorë dhe mësuesit duhet ta marrin me përgjegjësi dhe seriozitet nismën për t'u trajnuar në identifikimin dhe trajtimin e disleksisë. Nga diskutimet që kam pasur me kolegët e mi aktualë, por edhe paraardhës, shumë pak nga mësuesit e njohin dhe e identifikojnë disleksinë. Shumica e tyre, një fëmijë me disleksi e përcaktojnë si fëmijë që nuk mëson, fëmijë i zhurmshtëm etj. S. G. është nxënës i klasës së parë. Ai kishte në fillim shumë probleme me të nxënësit dhe mësuesja e tij nuk e

2 Shoqata Ndërkombëtare e Disleksikëve 2000: 6, përkthimi im.

njihte disleksinë. Kjo gjë e bëri më të vështirë punën me të. Nisur nga kjo, mora nismën për të mbajtur një seminar rreth njohurive që kisha rreth disleksisë.

Njohja e metodave efikase dhe joefikase në identifikim dhe trajtim, është detyrim profesional i çdo psikologu dhe mësuesi, në cilindo cikël arsimor. Disleksia mbetet problemi më i përhapur, por njëkohësisht, më i shpërfillur sot në shkolla dhe kjo duhet të ndryshojë sa më shpejt të jetë e mundur, pasi prindërit, mësuesit, drejtuesit e shkollave dhe të gjithë ata që janë përgjegjës për mbarëvajtjen e arsimit në Shqipëri, duhet të kuptojnë se ndërhyrja e hershme parandalon shumë probleme serioze akademike, emocionale dhe shoqërore të fëmijët dhe adoleshentët, të cilët kanë shumë potenciale dhe talente që presin të shprehen dhe zhvillohen.³

Si duhen mësuar nxënësit disleksikë

Nxënësve disleksikë u duhet treguar çdo gjë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ky lloj nxënësi nuk duhet quajtur dembel, pasi në fakt, ai po bën maksimumin e tij. Fëmijëve disleksikë u duhet më shumë kohë dhe energji sesa nxënësve të tjerë, për të bërë një punë të caktuar.

Nxënësit disleksik i duhen shpjeguar pjesët përbërëse, pastaj e përgjithshmjia dhe në fillim e thjeshta, pastaj e ndërlikuara. Gjithmonë me këta nxënës duhet që mësuesi të nisët nga ana pamore, për të mbërritur tek ana dëgjimore, duke përsëritur vazhdimisht ato çka nxënësi di.⁴

Një nxënësi disleksik i duhet një mjedis i qetë dhe me rregull për të mësuar. Atij nuk i duhen dhënë më shumë se dy udhëzime përnjëherësh. Kur i kërkon diçka fëmijës disleksik, duhen përdorur fjali të shkurtra dhe të thjeshta. Nxënësi disleksik ka nevojë për më tepër kohë për të kuptuar atë që dëgjon, për t'u përgjigjur dhe për të bërë detyrat.

Gjatë gjithë këtij viti shkollor kam punuar me disa nxënës disleksikë jashtë orarit mësimor.

A. L., klasa e gjashtë. Nuk lexonte dhe nuk i njihje shkronjat. Pas një pune të gjatë njëvjeçare, ai tani ka arritur të bashkojë shkronjat në rrokje dhe në fjalë, por ka ende vështirësi në rrjedhshmërinë e të lexuarit.

Y. H. ka vështirësi në të shkruar, por lexon mirë. Kam përdorur me të diktimet dhe punën individuale pas shkollës.

A. F. shkruan keq dhe me fjalë shpesh pa kuptim, ose me mungesë

³ Cara 2012: 85.

⁴ Shoqata Ndërkombëtare e Disleksikëve, 2000: 11, përkthimi im.

shkronjash. Me të kam ushtruar të kopjuarit dhe të lexuarin e asaj që ka kopjuar me zë të lartë.

E. H., nxënëse e vitit të dytë, me vështirësi në përvetësimin e asaj që lexon. Me të jam ulur dhe e kam lexuar unë së pari pjesën, pastaj kemi nxjerrë së bashku gjërat kryesore dhe, së fundmi, e kam lënë të lirë të punojë ajo vetë.

Përfundim

Me të gjithë këta nxënës kam pasur rezultat, pasi me këta fëmijë duhet kurajë, mosdiskriminim dhe punë e palodhur, por, në fund, ia arrihet edhe me nxënësit disleksikë.

Mësimi me nxënësit disleksikë duhet zhvilluar në mënyrë rutinore, me qëllim që ata të dinë se ç' do të vijojë më tej. Po ashtu, është e rëndësishme që këta nxënës të mbahen ulur pranë mësuesit, me qëllim që të mos shpërqendrohen nga gjërat e tjera në klasë.⁵

Bibliografia

1. **Bergeron, B., Bradbury-Wolf, M** (2003), *Të mësuarit e strategjive të të lexuarit në klasat fillore (Teaching Reading Strategies in the Primary Grades)*, UK: Scholastic.
2. **Cara, M.** (2012), *Disleksia identifikimi dhe trajtimi i saj në shkollat gjithëpërfshirëse*, në “Revista Pedagogjike” e Institutit të Zhvillimit të Arsimit, f. 85-96. http://www.izha.edu.al/materiale/Revista_Pedagogjike_2012.pdf
3. **Garro, S.** (2002), *Mësimdhënia bashkëkohore*, Tiranë, Toena.
4. **Garro, S.** (2002), *Sfidat e mësimdhënies*, Tiranë, Erik design, 2002.
5. **Gjokutaj, M.** (2009), *Didaktika e gjuhës shqipe*, Tiranë, ShBLU.
6. **Karaj, Th., Rapti, E., Tamo, A.** (2005), *Mësimdhënia dhe të nxënësit*, Tiranë: Mokra.
7. **Lentin, L.** (1979), *Dal parlare al leggere*, Emme Edizioni.
8. **Mialaret, Gaston** (1996), *L'apprendimento della lettura*, Romë: Armando Editore.
9. **Musai, B.** (1999), *Psikologji edukimi*, Tiranë, Shtypshkronja Pegi.
10. **Mustafa, A.** (2002), *Didaktika e gjuhës shqipe dhe e leximit letrar (për ciklin e lartë të shkollave fillore)*, Shkup, Logos A.

5 Shoqata Ndërkombëtare e Disleksikëve, 2000: 12, përkthimi im.

11. **Pinker, S.** (1997), D. Mc. Guinness, “*Përse fëmijët tanë nuk mund të lexojnë dhe çmund të bëjmë ne për këtë gjë (Why Our Children Can't Read and What Can We Do About It)*, Londër, Penguin Education.
12. **Shoqata Ndërkombëtare e Disleksisë** (2000) *Strategjitë e Mësuesit për Disleksikët*, http://www.visd.com/depart/specialprograms/dyslexial/dyslexia_handbook_teacherstrategies.pdf
13. **Tamo, A.** (2003), *Aspekte psiko-pedagogjike*, Tiranë, Instituti i Studimeve Pedagogjike.
14. **Tamo, A.** (2003), *Metodat direkte të mësimdhënies*, Tiranë.